



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 238, datë 13.11.2024

PËR

“TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM ME PËLQIM TË PROKURORIT BLERINA MUSABELLIU NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
3. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GERMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 13.11.2024, konform procedurës së përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Transferimin e përkohshëm me pëlqim të prokurorit Blerina Musabelliu në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”

BAZA LIGJORE:

- i. Neni 46, pika 1, ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;



- ii. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a", ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar;
- iii. Nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr.2521, datë 07.11.2024, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i është drejtuar KLP-se, nëpërmjet shkresës nr.4466 prot., datë 26.03.2024, administruar në institucion me nr.942 prot., datë 26.03.2024, me lëndë "Informim mbi gjendjen e ngarkesës në punë dhe kërkesë për plotësim të vendeve vakante të përkohshme me prokurorë dhe emërim të kancelarit në prokurori". Në këtë shkresë paraqitet ngarkesa e kësaj zyre prokurorie dhe nevoja imediate për plotësim të vendeve vakante për shkak të numrit shumë të ulët të prokurorëve që ushtrojnë efektivisht detyrën.
2. Duke qenë se, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka ngritur ende skemën e delegimit sipas përcaktimeve të nenit 45, të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar, Këshilli, pas kryerjes së procedurës nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës të ngarkesës së punës për secilin prokuror (numrin e çështjeve që kanë aktualisht nën hetim, në gjykim, si dhe çështje të tjera) në prokuroritë më të afërta Gjirokastër, Berat dhe Vlorë, u përzgjedh si kandidaturë e mundshme zonja Blerina Musabelliu, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër (caktuar në Seksionin për Dhunën ndaj të Miturve, për shkak të ngarkesës më të ulët të punës).
3. Në kushtet e emergjencës, me qëllimin për të mos shkaktuar bllokimin e punës në zyrën e prokurorisë Fier, Këshilli miratoi me vendimin nr. 72, datë 10.06.2024, transferimin përkohësisht me pëlqimin e saj, të zonjës Blerina Musabelliu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një periudhë nga data 10.06.2024 – 05.12.2024.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

4. Në zyrën e prokurorisë Fier janë parashikuar në organikë njëzet e katër prokurorë, nga të cilët shtatë janë të pezulluar për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe një prokuror është i komanduar pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Aktualisht në detyrë së bashku me



drejtuesin janë pesëmbëdhjetë prokurorë, nëntë nga të cilët janë emëruar në vitet 2022, 2023 dhe 2024.

5. Duke qenë se, kushtet e funksionimit të zyrës së prokurorisë Fier nuk janë përmirësuar, si dhe në kushtet kur prokurorja Musabelliu ka ushtruar detyrën për 6 muaj pranë kësaj zyre prokurorie në trajtimin e dosjeve penale, me qëllim vijimin normal të punës, Komisioni vlerësoi transferimin e prokurores Musabelliu edhe për një periudhë tjetër 6 mujore nëpërmjet instrumentit të “Transferimit të Përkohshëm me pëlqim”, për të plotësuar një nga vendet e përkohshme të lira vakante.
 6. KLP vlerëson fillimisht të saktësojë se ky transferim do të bëhet referuar nenit 46 “Transferimi i përkohshëm” të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar që parashikon se:
 - i. *“Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magistrat të disponueshëm, Këshilli mund t’i kërkojë magistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t’u transferuar ose për t’u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magistrati”.*
 7. Gjithashtu, në këtë transferim do të zbatohen kërkesat e Kreut II “Transferimi me pëlqim” të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”. Më konkretisht vendimmarrja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ka mbajtur parasysh përcaktimet e neneve 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Rregullores së sipërcituar. Në mënyrë specifike neni 6 pika 5 ku përcaktohet se:
 - i. *“5. Transferimi me pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:
 - a) Prokurori ose prokurorët që japin pëlqimin fillimisht duhet të jenë nga prokuroria me ngarkesën mesatare më të ulët për prokuror, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;
 - b) Prokurori duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t’u transferuar përkohësisht.”*
8. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, rezulton se prokurorja Blerina Musabelliu, plotëson kriteret e vendit të punës ku do të transferohet.
Për kandidaten Blerina Musabelliu, duke iu referuar të dhënave të dosjes personale, konstatohet se:
 - Me vendimin nr. 170, datë 12.07.2022, të KLP-së është emëruar magjistrate”;
 - Me vendimin nr.216, datë 12.07.2022, të KLP-së është caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër.Gjithashtu, rezulton se kjo candidate nuk ka masë disiplinore në fuqi.
9. Nga ana tjetër neni 15 pika 2 të ligjit Nr. 96/2016 i ndryshuar, përcakton se:
 - i. *“Magjistrati në skemën e delegimit, magistrati i transferuar përkohësisht ose magistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose*



caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magjistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht.”

10. Duke qenë se, aktualisht, Këshilli ka miratuar Rregulloren për *“Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”*, pagesa e prokurores Musabelliu, do të bëhet sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
11. Në këtë kontekst, KLP referuar përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të përmendura më sipër, konsideron kandidaturë të përshtatshme prokuroren Blerina Musabelliu, si kandidatë që plotëson kriteret për transferimin përkohësisht me pëlqimin e saj, në detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një periudhë tjetër 6 mujore nga data 10.12.2024 deri më 09.06.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores *“Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”*,

V E N D O S I:

1. Zonja Blerina Musabelliu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, transferohet përkohësisht me pëlqimin e saj, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Zonja Blerina Musabelliu do të ushtrojë detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përkohësisht nga data 10.12.2024 – 09.06.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Blerina Musabelliu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
4. Gjatë periudhës së transferimit zonja Blerina Musabelliu do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, sipas përcaktimeve Rregullores për *“Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”*.



5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2024.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Germenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla